




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPALITY OF GJILAN/GILAN  
BELEDIYESI



Zyra e Kryetarit

## NJESIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

### KONKURS

#### Manifestimi “Flaka e Janarit 2015”

##### 1. Arti Letrar

Komuna e Gjiçanit, në kuadër të Manifestimit kombëtar të kulturës “Flaka e Janarit 2015”, shpall konkursin tradicional letrar për tregim të shkurtër dhe për poezi, me qëllim të nxitjes dhe avancimit të vlerave letrare të krijuesve nga të gjitha trevat shqiptare dhe kudo ku jetojnë ata që shkruajnë shqip.

Tema e konkursit është e lirë. Konkursi është anonim, i hapur deri më 20 janar 2015 dhe me shifër. Punimet e pabotuara (në libra, gazeta e revista, portale, internet si dhe rrjete sociale) dërgohen në tri kopje, në adresën: Komuna e Gjiçanit, Njësia për Kulturë, Rini dhe Sport dhe në adresën elektronike: [penaflakes2015@gmail.com](mailto:penaflakes2015@gmail.com)

Rezultatet e konkursin shpallen në Orën e Madhe Letrare “Pena e Flakës 2015”. Të gjithë konkurruesit duhet t’u përmbahen kritereve dhe afatit të konkurrimit.

#### Për tregim të shkurtër (deri në tri faqe me rreshta të rrallë)

Çmimi i parë..... 250 euro  
Çmimi i dytë..... 200 euro  
Çmimi i tretë.....150 euro

#### Për poezi (deri në 50 vargje)

Çmimi i parë..... 250 euro  
Çmimi i dytë..... 200 euro  
Çmimi i tretë.....150 euro

Krijimet e shpërblyera dhe ato që sugjerohen për botim, do të botohen në revistën letrare-kulturore AGMIA.

##### 2. Arti Pamor

Për punimet e sferës së Artit Pamor, për Ekspozitën kolektive mbarëkombëtare, që do të hapet në Galerinë e Qytetit. Të gjithë artistët profesionalë mund të konkurrojnë me një (1) vepër, përmasat e së cilës duhet të jenë jo më të mëdha se 120 cm. (Çmimi blerës për fondin e galerisë – 500 € dhe tri çmime tjera në vlerë prej 150 €). Punimet, jo më të vjetra se dy vite, teknikisht të përgatitura dhe të pa ekspozuara më parë, me tematikë të lirë, dorëzohen në Galerinë e Qytetit, gjatë orarit të ditët e punës, deri më 9 janar 2015.

Në konkurs, mund të marrin pjesë krijuesit e të gjitha zhanreve të artit pamor nga të gjitha trojet tona etnike, ndërkaq që punimet e përzgjedhura do të katalogohen.

### **3. Arti Muzikor**

Festivali mbarëkombëtar i këngës popullore në frymën e traditës fton interpretuesit e këngës popullore shqipe. Të drejtë konkurrimi kanë të gjithë interpretuesit e pasionuar, nga të gjitha trevat shqiptare, që kultivojnë këtë zhanër.

Mosha e lejuar - mbi 18-vjeç.

Te gjithë interpretuesit konkurrues do t'i nënshtrohen audicionit

Juria profesionale do të vlerësojë interpretuesit të cilët do të garojnë për këto shpërblime:

- a) Çmimi i parë – 400 euro
- b) Çmimi i dytë – 300 euro
- c) Çmimi i tretë – 200 euro.

Këngët do të interpretohen drejtpërdrejtë nën përcjelljen e orkestrës profesionale-Gjilan.

Afati i aplikimit është deri më 12 Janar 2015.

Aplikimi mund të bëhet në Njësinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Gjilan

Adresa: ndërtesa e Teatrit të qytetit, kati II ose në adresën elektronike:festflaka2015@gmail.com

**Ndërsa për “Xixat e Flakës”** koncert i organizuar për fëmijë, me këngë të reja apo të kënduara, afati i aplikimit është deri më 9 janar 2015. Aplikimi mund të bëhet në Njësinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Gjilan, adresa: ndërtesa e Teatrit të qytetit, kati II ose në adresën elektronike:xixat2015@gmail.com

### **4. Arti Dramatik**

Do të përzgjidhen pesë shfaqje teatrale, mundësisht me përfaqësim nga trevat mbarëkombëtare, duke mundësuar prezantimin e vlerave më të mira të dramës shqipe.

Konkursi është publikuar në gazeta dhe në uebfaqen zyrtare të Komunës së Gjilanit: [kk.rks-gov.net/gjilan](http://kk.rks-gov.net/gjilan)